



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	03.09.2022
Referencë	11-344/9
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani - Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-shtator

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit që lamë pas, inspektorati ka realizuar inspektime bazuar në agjendën mujore, duke prekur secilën problematikë e cila trajtohet me kompetencë komunale të inspektoratit.

Ndër prioritetet për këtë muaj ka qenë dhe vazhdon të jetë, vizitat inspektuese në deponitë ilegale të mbeturinave në fshatrat që përbëjnë komunën tonë. Inspektimi është realizuar edhe gjatë ditëve të vikendit, gjithashtu planifikim i tillë është paraparë edhe gjatë vikendeve të ardhshme. Kujdestaritetë kanë rezultuar suksesshëm, pasi që janë ndaluar persona të ndryshëm duke hedhur dhe duke ndezur mbeturina, ndaj të cilëve janë marr të gjitha masat ligjore.

Gjithashtu agjendës së planifikuar mujore i janë shtuar edhe ankesat e qytetarëve të cilat kanë qenë të shumta, e të ndryshme. Jemi përgjigjur ankesës së qytetarëve në Glllogovc, ankesa ishte, mbyllje të kanaleve të ujërave atmosferik dhe dëmtim të tokave bujqësore përgjatë hekurudhës si pasoj e punimeve në hekurudhë. Ankesa tjera, hudhje e mbeturinave në disa raste, zjarr-venie gjithashtu në disa raste, pengesa mes operatoreve lidhur me linjat e autobusëve.

Prioritet tjetër për muajin shtator, e që vazhdon të mbetet prioritet është ndalimi i shitjes jashtë tregut. Të cilën dukuri e kemi ndaluar në vazhdimësi (pasi që vazhdon të përsëritet).

Problematikë tjetër me të cilën është marr inspektorati, është problemi që kanë paraqitur firmat e ndryshme ndërtimore, të cilat janë duke realizuar punë brenda qytetit, e të cilat në shumë raste kanë bllokuar rrugët dhe trotuaret.

Dëmtimi i rrugës nga një kompani gjatë intervenimit që ka pasur në Janjevë dhe mos kthimi i rrugës në gjendjen e më parshme, ka detyruar inspektoratin të procedoj fletëparaqitje për gjykatë ndaj kompanisë (e cila fletëparaqitje vie pas mos respektimit të urdhëresës).

Kemi bërë inspektim të vazhdueshëm të tregjeve. Në tregun e gjelbër nuk është lejuar tregtimi jashtë hapësirave të tregut, inspektim-kontroll është realizuar dhe te tregu i mobileve dhe ai i kafshëve.

Inspektorët kanë qenë aktiv edhe në zonat urbane, ekonomike, industriale. Të gjitha rastet pa-leje ndërtimore janë ndaluar dhe ndaj secilit rast janë duke u ndjekur hapat procedural ligjor.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit shtator janë:

Kontrollimi i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektim për auto-taskive firmave të autobusëve për rend udhëtimiti.

Ndalimi i tregtimit në rrugët e qytetit.

Inspektim-kujdestari të organizuara në deponitë ilegale.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi .

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë dhe sanimi i tyre sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët																	
Gjithsej inspektime																	
Inspektime me procesverbal																	
Pranime teknik																	
Fletëparaqitje																	
Vendosje të shiritav zyrtar																	
Kallëzim penal																	
Pranim teknike te objekteve me komision																	
Vërejtje, njoftime																	
Refuzim per legalizim të objekteve nga DPU-ja																	
Të hyra nga pranimet teknike																	
Njoftime për objektet e legalizuara																	
Punë me palë, ankesa , kërkesa																	
Lendet e pranuar																	
Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore																	
Gjoha mandatore																	
Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike																	
Barazim i të hyrave																	
Menaxhim I tregjeve dhe i kontratave për ndërtim																	
Aktvendime, ndalesa, urdhëresa, vendime , shkresa																	
Inspektim me polici																	
Asgjësimit malli																	
Biznesi																	
Ambienti	12	3								6			1				
Ndërtimi	18	4		2		4	2			4					2		
Trafiku	49	3	1				18			2	2	2	1		6	14	
Gjithsej	79	10	1	2		4	20			12	2	2	2		6	2	16

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur, por kemi pasur takime me qytetarë në mënyrë individuale.

TAKIME TË TJERA

Takimet kryesisht i kemi mbajtur me qytetarë, pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë.

SFIDAT

Parandalimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore, inspektim i trotuare, rrugëve, hapësirave gjelbëruese, inspektim i taksiv ilegal.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi në çdo lëmi që të njoftojnë Drejtoratin e Inspeksionit, në mënyrë që cilësia në shërbime të jetë në nivel më të mirë të mundshëm.